



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

| | | |
|--|-----------|-------------------------------|
| Pranuar / Dërguar Prijmleno / Predato Received / Delivered | 03.02.23 | 3 viti god year |
| Organ / Rjesja Organ / Jednica Org. Unit | 1380/2023 | Sasia Kolicina Quantity |
| Dr. Prof. Dr. Prof. | | |
| Shiqje e Prilog Appendix | | |



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.61/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi-Kryetare, Arben Mehmeti dhe Ardita Haxhnikaj Demi -anëtarë, me Zyla Millaku-Gojnovci - Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.61/2023 të datës 13.01.2023, të parashtruar përmes postës elektronike ankesa.kpmshck@rks-gov.net , nga ankuesja

kundër organit të punësimit Komunës së Lipjanit , në çështjen juridike “Shkelje e të drejtës në pagë” në mbështetje të nenit 6 paragrafi 1 nën paragrafin 1.1, nenit 16 paragrafi 3 dhe nenit 18 paragrafi 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 02.02.2023, mori këtë:

V E N D I M

Përfundon procedimi administrativ i filluar sipas ankesës me numër A.nr.61/2023 të datës 13.01.2023 të parashtruar nga ankuesja

A r s y e t i m

Ankuesja Zyrtare për Leje Ndërtimore pranë Drejtorisë për Planifikim, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit në Komunën e Lipjanit, me datë 13.01.2023 ka parashtruar ankesë me numër të protokollit 252/2023 të regjistruar nën shenjë A.nr.61/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, lidhur me harmonizimin e koeficientit të pagës me titullin e pozitës dhe përkrahimin e vendit të punës, nga koeficienti aktual gjashtë (6) në koeficientin e pagës tetë (8).

Kolegji i Këshillit duke marrë parasysh se pretendimet ankimore të ankuesit kanë për objekt çështjen e harmonizimit të koeficientit të pagës, thekson faktin se Kuvendi i Republikës së Kosovës, me datë 22.12.2022 ka aprovuar Ligjin Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publikë, i cili me datë 05.01.2023 është publikuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës Nr.1/5 Janar 2023, dhe si rrjedhojë i njëjti hynë në fuqi një (1) muaj pas publikimit në gazetë zyrtare, respektivisht me datën 05.02.2023. Me këtë ligj parashihen rregulla dhe kushte tjera për përcaktimin e pagës të të punësuarve në



sektorin publikë, duke përfshi edhe koeficientet dhe nivelet e koeficienteve të pagës të cilat ndryshojnë nga rregullat dhe sistemi aktual i pagave.

Për me tepër, me dispozitat kalimtare të këtij ligji shfuqizohet Ligji Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil, ndërsa me nenin 42 paragrafi 1 është përcaktuar së gjatë periudhës tranzitore të kalimit në sistemin e ri të pagave, ndalohet çdo ndryshim në strukturën, komponentët apo nivelet e koeficienteve aktual të pagave.

Andaj, për sa me sipër dhe duke marr parasysh faktin se pas parashtrimit të ankesës nga pala ankuese kanë ndryshuar rrethanat ligjore dhe faktike mbi të cilat janë ngritur pretendimet ankimore, Kolegji i Këshillit konstaton se objekti për të cilën ka filluar procedimi administrativ është bërë i pamundur apo i kotë, ngase edhe nëse do të kishte vendimmarrje pozitive, për shkak të rrethanave të krijuara si pasojë e bazës së re ligjore, koeficienti i ndryshuar i pagës nuk mund të aplikohet në sistemin e ri të pagave.

Kështu që duke u bazuar në dispozitat e Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, përkatësisht nenin 104 ku përcaktohet se: *Procedura administrative gjithashtu përfundon kur organi publik kompetent vlerëson se objekti për të cilin ishte nisur procedura ose qëllimi i saj është bërë i pamundur apo i kotë*, si dhe nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi për përfundimin e procedimit administrativ, si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda. A.nr.61/2023

Zyle Millaku-GOJNOVCI

Procesmbajtëse

Vendimi i dorëzohet:

- Ankueses
- Kryetarit të Komunës së Lipjanit;
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Lipjanit dhe
- Arkivit të KPMSHCK- së.

Malsore Gashi-BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

